

V E N D I M
Nr.319, datë 30.6.1993

PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE SHQIPTARE TË DETYRUESHME

Në zbatim të nenit 4 të ligjit nr.7630, datë 28.10.1992 "Për standardizimin dhe cilësinë", me propozimin e Drejtorisë së Standardizimit dhe të Cilësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Standardet shqiptare të detyrueshme të jenë:

a) Në bujqësi e blegtori dhe pyje

1. Materiale mbjellëse (fara e fidanë të të gjitha llojeve e riprodhimeve, kalema, copa, bulba, zhardhokë etj.).

2. Kafshë race, familje bletësh e fshikëza mëndafshi.

3. Mjaltë blete, dyllë, pite (fletë dylli), vezë etj.

4. Kafshë e shpendë për tharje të të gjitha llojeve.

5. Ushqime të kombinuara për kafshët dhe shpendët.

6. Drithëra buke (grurë, misër, oriz e thekër).

7. Duhan, ullinj, panxharsheqeri, elb distik e rrush (për përpunim).

b) Në industrinë ushqimore

- Të gjitha standardet e lëndëve të para, të materialeve ndihmëse dhe të produkteve të gatshme ushqimore.

c) Në materiale ndërtimi e ndërtime

1. Rregulla të përgjithshme dhe norma.

2. Materiale ndërtimi.

3. Konstrukione dhe detaje druri, tulle, betoni e hekurbetoni.

ç) Në lëndën e drurit dhe prodhimet prej druri

1. Lëndë druri dhe për përpunim.

2. Prodhimet e kimisë së drurit.

d) Në naftë, hidrokarbure të gazta dhe produktet e tyre

1. Naftë, gaz i thatë dhe gaz i lëngët.

2. Lëndë djegëse të lëngta e të ngurta.

3. Vajra lubrifikante.

4. Prodhime naftë për industri e përdorim të gjerë.

5. Shtesa në karburante, vajra e lubrifikuese të ndryshme.

dh) Në mineralet

1. Minerale të pasuruara të kaolinave, dolomiteve dhe olivinëve.

2. Kripë guri, kuarcitet dhe kripë deti.

e) Në mekanikë, elektroteknike dhe automatike

1. Standardet e lëndëve të para dhe ndihmëse.

2. Detaje të veçanta e lidhëse, nyja dhe pajisje të përdorimit të përgjithshëm në makina.

3. Instrumente dhe pajisje matëse. Shenjat në vizatimet teknike. Armaturat.

4. Makina për industrinë e rëndë e të lehtë, ushqimore, përpunim druri, bujqësi dhe transport.

5. Pajisje, transportuese dhe makina: me avull; lëndë djegëse të lëngët, të gaztë e të ngurtë; elektrike; të presionit të lartë etj.

6. Aparate, pajisje dhe detaje për matje të presionit, sasisë, nivelit, temperaturës, elektronikës, elektrikut etj.

ë) Në tekstil, konfeksione dhe lëkurë këpucë

1. Lëndë e parë, pambuk, lesh dhe artificiale.

2. Fill leshi, pambuku e artificiale, si dhe me përzierje.

3. Pëlhura pambuku e të leshta.

4. Veshje të brendshme të trikotuara dhe rroba pune.

5. Lëkurë të përpunuara dhe këpucë pune.

f) Në industrinë kimike

1. Gaze industriale, acide, baza dhe kripëra.
2. Plehra kimike dhe lëndë për luftimin e dëmtuesve në bujqësi.
3. Lëndë të para ndihmëse e prodhime plastike që përdoren për konsum të brendshëm nga njeriu, në elektroshtëpiake, sigurimin e jetës, lodra fëmijësh, ambalazhe ushqimore dhe pajisje hidrosanitare.

4. Reagentë kimikë, lëndë eksplozive.

5. Prodhime qeramike, elektro-ngrohëse.

6. Prodhime kimike që dëmtojnë direkt ose gjatë përpunimit emetojnë lëndë të dëmshme për shëndetin e njeriut.

g) Të tjera

1. Të gjitha metodat e standartizuara të analizave laboratorike dhe organoshqisore që përdoren për vlerësimin cilësor të lëndëve të para dhe produkteve të gatshme.

2. Gjithë fjalorët terminologjikë të standardizuar.

3. Standardi i etiketave.

4. Standardet e ambalazheve

II. Emërtimin e standardeve të detyrueshme brenda çdo grupi (veçmas për çdo prodhim, ndërtim e shërbim) autorizohet ta përcaktojë e miratojë Këshilli i Standardizimit, që funksionon pranë Drejtorisë së Standardizimit dhe të Cilësisë.

III. Lejet për treguesit cilësorë të prodhimeve, ndërtimeve e shërbimeve, për të cilët ka standarde të detyrueshme ose dokumente të tjera që barazohen me to, jepet nga dega e standardizimit dhe e kontrollit të cilësisë në rrethin përkatës, pasi personi fizik a juridik të ketë paraqitur pranë saj standardin, parastandardin, kushtin e projektimit, të zbatimit, kampionin, modelin ose recepturën përkatëse, të miratuara nga organi i emërtesës që i ka në kompetencë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi